

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetar i trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Xhemile Bejtullahu, në çështjen penale ndaj të pandehurit R. A., nga fshati S., Komuna e K., të cilin sipas autorizimit e mbron avokati Sh. P., nga Gj., për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.91/2014, e datës 28.05.2014, të cilën e përfaqësonte prokurori i shtetit Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 12.06.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë :

AKTGJYKIM

I pandehuri R. A., nga babai N. dhe nëna R., e lindur M., i lindur më ..., në fshatin S., Komuna e K., ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Sepse më datën ... 2014, rreth orës ... minuta, në K., në Lagjen “...” në drejtim të fshatit S., i pandehuri duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës “...”, “...”, me targa të regjistrimit ..., me dashje eventuale ka shkelur nenin 54 paragrafi 1 dhe nenin 227 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor,² në atë mënyrë që ka rrezikuar trafikun publik, duke mos iu përshtatur shpejtësisë dhe kushteve në rrugë, në gjendje të paaftë dhe nën ndikim të alkoolit në gjendje të dehur 1.7 % alkool në gjak, ashtu që si pasojë e ngasjes së automjetit me shpejtësi prej 65 km/h. del me automjet në shiritin e kundërt të rrugës, me ç’rast me pjesën e përparme të anës së majtë e godet të dëmtuarin tani të ndjerin J. M., pjesëtar i policisë në kryerje të detyrës zyrtare, i cili derisa kishte ndaluar një veturë të markës “...” në shiritin tjetër të lëvizjes, i cili ishte pozicionuar pranë derës së shoferit, nga ana e kundërt i pandehuri duke e ngas veturën e tij e godet me pjesën e përparme të anës së majtë, duke e përplasur për toke dhe si pasojë e plagëve të marra i njëjti nuk mund të mbijetoj,

- me këtë ka kryer vepër penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 62, 68, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 248 paragrafi 4 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP),³ të pandehurit R. A. i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të pandehurit R. A., i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim i pandehuri do ta mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Përveç dënimit kryesor (dënimit me burgim), ndaj të pandehurit R. A., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja e lejes së vozitjes të kategorisë “B”, “C” dhe “E” dhe i ndalohet të pandehurit marrja e lejes së re të vozitjes në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve, nga data kur

² Ligji nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, i datës 11.11.2007.

³ Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejshëm KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Koha e kaluar në burg, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues.

Ndaj të pandehurit R. A., ndërprehet paraburgimi dhe i njëjti është liruar më datën 12.06.2014.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të pandehurit R. A., do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.04.2014 e deri më datën 12.06.2014, në atë mënyrë që 1 (një) ditë paraburgim barazohet me 1 (një) ditë burgim.

Familjarët e të ndjerit J. M., për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohen në kontest civil.

Detyrohet i pandehuri R. A., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 459.9 € (katërqindepesëdhjetenëntë Euro e nëntëdhjetë Cent) në emër të kompensimit të ekspertëve për ekzaminimin e veturës; shumën prej 459.9 € (katërqindepesëdhjetenëntë Euro e nëntëdhjetë Cent) në emër të kompensimit të shpenzimeve të ekspertëve për super ekspertizë, si dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në emër të paushallit gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

ARSYETIMI

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 28.05.2014 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit R. A., nga fshati S., Komuna e K., për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të KPRK.

Pas dorëzimit të aktakuzës në Gjykatë, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar dhe gjatë shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i pandehuri R. A., ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën

akuzohet, si dhe ka deklaruar se e pranojë fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohem sipas aktakuzës së lartcekur.

2. Vlerësimi pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve, mbrojtësit të të pandehurit, avokatit Sh. P. dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit F. N., ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin Sh. P.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza (siç janë : superekspertiza mbi aksidentin e komunikacionit; fotografitë që gjenden në shkresa të lëndës; skica nga vendi i ngjarjes; raportet e oficerëve policor; ekzaminimi i veturës nga ana e ekspertëve; deklaratave të dëshmitarëve dhe të pandehurit; alkool-testi; provave tjera materiale, etj.) dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri R. A., me dashje eventuale dhe nën ndikimin e alkoolit e ka kryer veprën penale ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4. Kompetenca e gjykatës

4.1. Kompetenca territoriale - Kryetari i trupit gjykues, ka vlerësuar se Gjykata Themelore në Gjilan, duke u bazuar në nenin 29 paragrafi 1 të KPP, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se vepra penale është kryer në Kamenicë, që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate.

4.1. Kompetenca lëndore - Duke u bazuar në nenin 21 paragrafi 4 dhe në nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 21 të Ligjit për Gjykatat,⁴ Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku i pandehuri akuzohet për shkak të veprës penale ngasje në gjendje ë paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të KPRK, ngase për këtë vepër penale është parashikuar dënimi me burgim prej 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.

4.1. Kompetenca funksionale - Në nenin 248 paragrafi 4 të KPP, është parashikuar se “kur kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose...”. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, kryetari i trupit gjykues (si gjyqtar i vetëm) ka kompetencë funksionale për të shqiptuar dënimin ndaj të pandehurit, nëse paraprakisht ka marrë aktvendimin për pranimin e fajësisë. Përveç kësaj, edhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës,⁵ ka sqaruar se në raste të tilla kryetari i trupit gjykues ka kompetencë funksionale për ta shqiptuar dënimin.

5. Elementet e veprës penale

Kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin R. A., për shkak të veprës penale ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur, nga neni 379 paragrafi 4 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i

⁴ Ligji nr.03/L-199 për Gjykatat, i datës 22.07.2010.

⁵ Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJA.nr.207/2013, e datës 19.03.2013; Shkresa e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJ.nr.528/2013, e datës 04.09.2013, si dhe qarkorja e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, GJA.nr.194/2014, e datës 08.05.2014.

përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti, siç e ka pranuar edhe vetë, ditën, vendin dhe në kohën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me dashje eventuale duke drejtuar automjetin e udhëtarëve të markës "...", "...", me targa të regjistrimit ..., ka shkelur nenin 54 paragrafi 1 dhe nenin 227 paragrafi 1 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, në atë mënyrë që ka rrezikuar trafikun publik, duke mos ia përshtatur shpejtësisë dhe kushteve në rrugë, në gjendje të paaftë dhe nën ndikim të alkoolit në gjendje të dehur 1.7 % alkool në gjak, ashtu që si pasojë e ngasjes së automjetit me shpejtësi prej 65 km/h. del me automjet në shiritin e kundërt të rrugës, me ç'rast me pjesën e përparme të anës së majtë e godet të dëmtuarin tani të ndjerin J. M., pjesëtar i policisë në kryerje të detyrës zyrtare, duke e përplasur për toke dhe si pasojë e plagëve të marra i njëjti nuk mund të mbijetoj.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetari i trupit gjykues, duke e marrë për bazë peshën dhe natyrën e veprës penale, pasi që kishte marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, duke u bazuar në nenin 248 paragrafi 4 të KPP, kishte caktuar një seancë me qëllim të vërtetimit të fakteve relevante lidhur me dënimin, seancë kjo e cila është mbajtur ditën e njëjtë kur është mbajtur edhe shqyrtimi fillestar.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit R. A., kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK. Në këtë aspekt, si rrethana lehtësuese për të pandehurin, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë; se gjatë shqyrtimit fillestar i ka shprehur keqardhje familjes së të ndjerit për rastin që ka ndodhur dhe pendimin e të pandehurit. Gjithashtu, si rrethana lehtësuese për të pandehurin kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, fakt ky i cili

është vërtetuar nga shkresat e referentëve të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë faktin se si rezultat i kësaj vepre penale është shkaktuar vdekja e një oficeri të Policisë së Republikës së Kosovës, gjatë kohës sa i njëjti ka qenë duke i kryer detyrat zyrtare.

7. Dënimi plotësues

Duke u bazuar në nenin 62 dhe në nenin 68 të KPRK, përveç dënimit kryesor (dënimit me burgim), ndaj të pandehurit R. A., është shqiptuar edhe dënimi plotësues marrja e lejes së vozitjes të kategorisë “B”, “C” dhe “E” dhe i është ndaluar të njëjtit marrja e lejes së re të vozitjes në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Koha e kaluar në burg, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi plotësues. Kryetari i trupit gjykues e ka shqiptuar këtë dënim plotësues, për shkak se siç parashihet edhe në nenin 68 paragrafi 2 të KPRK, i pandehuri duke e rrezikuar sigurinë në trafikut publik e ka shkaktuar vdekjen e një personi dhe se kryetari i trupit gjykues ka vlerësuar se shqiptimi i këtij dënimi plotësues është i domosdoshëm për tu arritur qëllimi i dënimit.

8. Shqiptimi i dënimeve në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimeve të shqiptuara

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimi plotësues, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave

penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

9. Vendimi për ndërprerjen e paraburgimit

Gjatë marrjes së aktgjykimit, kryetari i trupit gjykues ka vendosur që ndaj të pandehurit R. A., të ndërprehet paraburgimi dhe i njëjti është liruar më datën 12.06.2014, ngase kanë pushuar së ekzistuari arsyet ligjore për mbajtjen e mëtejme në paraburgim.

10. Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar me burgim

Duke u bazuar në nenin 83 paragrafi 1 dhe 4 të KPRK, kryetari i trupit gjykues ka vendosur në dënimin e shqiptuar me burgim, të pandehurit R. A., do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 15.04.2014 e deri më datën 12.06.2014, në atë mënyrë që 1 (një) ditë paraburgim do të barazohet me 1 (një) ditë burgim.

11. Kërkesa pasurore juridike

Kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që familjarët e të ndjerit J. M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike t'i udhëzojë në kontest civil.

12. Mosaprovimi i propozimit të prokurorit të shtetit për konfiskimin e veturës

Kryetari i trupit gjykues, ka vendosur që mos ta aprovojë propozimin e prokurorit të shtetit të paraqitur në aktakuzë për konfiskimin e veturës "...", ngase është vlerësuar se edhe vetëm me shqiptimin e dënimit me burgim dhe dënimit plotësues marrja e lejes së vozitjes mund arrihet qëllimi i dënimit. Përveç kësaj, kryetari i

trupit gjykues nuk e ka aprovuar propozimin të prokurorit të shtetit për konfiskimin e veturës, edhe për shkak të faktit se vetura e lartcekur është në pronësi të personit të quajtur B. M., fakt ky i cili është vërtetar në bazë të policës së sigurimit ... dhe çertifikatës së regjistrimit të automjetit

13. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar nënin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale dhe atë shumën prej 459.9 € (katërqindpesëdhjetenëntë Euro e nëntëdhjetë Cent) në emër të kompensimit të ekspertëve për ekzaminimin e veturës; shumën prej 459.9 € (katërqindpesëdhjetenëntë Euro e nëntëdhjetë Cent) në emër të kompensimit të shpenzimeve të ekspertëve për super ekspertizë, si dhe shumën prej 50 € (pesëdhjetë Euro), në emër të paushallit gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 13.06.2014

Sekretarja juridike,
Xhemile Bejtullahu

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.